



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.251/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, Nr.REF-59407-05-29-2020 me objekt “*Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore ,ne Drejtorine e Sherbimit Spitalor Pogradec –Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat (24 muaj)*“, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 8,450,000, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.06.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec.

**Ankimues:** “Medi Tel” shpk  
Autostrada Tiranë Durrës, Km.1, Rruga Vidhe Gjata,  
nr.18, Tiranë

“Pura Medical” shpk  
Ish Reparti i Kipit të Furrënaltës pranë Kombinatit  
Metalurgjik Elbasan

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec ,  
Rr , “Islam Dani “, Lagjia Nr . 5 Pogradec

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.3. Operatori ekonomik “Medi Tel” shpk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërsa operatori ekonomik “Pura Medical” shpk nuk ka respektuar afatet e paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.06.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Nr.REF-59407-05-29-2020 me objekt “Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore ,ne Drejtorine e Sherbimit Spitalor Pogradec – Marreveshje Kuader me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara –

me afat (24 muaj)“, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 8,450,000, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.06.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec.

II.2. Në datën 03.06.2020 operatori ekonomik “Medi Tel” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- Në pikën 3.1.c “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, parashikohet: *Kandidati ofertuesi duhet të dorëzojë: Leje mjedisore të tipit C (III.1.A) Për pastrim, larje, sprucim, ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierte në mënyrë që të ripërdoren. Kërkesa e mësipërme është diskriminuese dhe pengon OE të marrin pjesë në prokurime mbi bazën e një kërkesë të paplotë. Theksojmë se OE Medi Tel shpk operon duke përdorur kontenitorë plastikë njëpërdorimësh dhe si i tillë pajisjen me impjant për larjen apo dezinfektimin e kontenitorëve (Leje mjedisore të tipit C (III.1.A) e shikon totalisht të panevojshme sepse kontenitorët që kjo shoqëri përdor asgjësohen bashkë me mbetjet dhe nuk ka asgjë për tu larë apo dezinfektuar. Në këto kushte AK nuk ka të drejtë të vendosë një kërkesë kaq diskriminuese por duhet ta heqë atë ose ta zëvendësojë me:*

*Kandidati ofertuesi duhet të dorëzojë Leje mjedisore të tipit C (III.1.A) Për pastrim, larje, sprucim, ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierte në mënyrë që të ripërdoren ose një vetdeklarim, ku deklaron se kontenitorët që ai përdor janë njëpërdorimësh. Kriteri i mësipërm shkel nenin 2 të LPP.*

*Sa më sipër kërkojmë që ky kriter duhet të hiqet nga AK ose të plotësohet Leje Mjedisore e tipit C (III.1.A) Për pastrim, larje, sprucim, ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierte në mënyrë që të ripërdoren ose një vetdeklarim, ku deklaron se kontenitorët që ai përdor janë njëpërdorimësh.*

- *Pika 3.3.c Kapaciteti teknik: Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve. Për këtë operatori duhet të paraqesë dokumentacionin se ka punësuar dhe regjistruar në listpagesa për 6 muajt e fundit të deklaruar në organet tatimore dhe sigurimet shoqërore. Minimumi 1 Inxhinier Mjedisi ose ekuivalent; Minimumi 1 Inxhineir Kimik ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër. Librezë Pune përkatëse, CV përkatëse, Kontratë Pune e Vlefshme përkatëse, Diplomë përkatëse.*

*Lidhur me pikën 3.3.c AK duhet të jetë më e qartë pasi ka hapësirë për keqinterpretim pasi duke kërkuar Minimumi 1 Inxhinier Mjedisi ose ekuivalent; dhe Minimumi 1 Inxhineir Kimik ose ekuivalent , AK nuk është e qartë nëse kërkon minimumi 2 inxhiniera kimist ose ekuivalent dhe inxhinier mjedisi ose ekuivalent të ndryshëm nga njëri tjetri apo mjafton që OE të ketë të punësuar 2 inxhinierë të cilët mund të jenë edhe të dy të një profili.*

*Nisur nga kjo kërkojmë nga AK ndryshimin ose plotësimin e këtij kriteri.*

II.3. Me shkresën nr.208 prot datë 05.06.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit ku ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës lidhur me pikën 2 të saj sqarimin lidhur me inxhinierët e kërkuar.

II.4. Në datën 11.06.2020 pala ankimuese “Medi Tel ” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me pikën 1 të ankesës Leje Mjedisore të tipit C (Kodi III.1.A).

II.5. Në datën 09.06.2020 operatori ekonomik “Pura Medical” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Me shkresën nr.219 prot datë 10.06.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit ku ka vendosur refuzimin e ankesës për shkak të paraqitjes së ankesës jashtë afateve ligjore.

II.7. Në datën 15.06.2020 pala ankimuese “Pura Medical ” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.226 prot., datë 19.06.2020 protokolluar me tonën me nr.544/2 datë 22.06.2020 me objekt “*Dërgohet informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “Në pikën 3.1.c “*Kriteret e vecanta të kualifikimit*”, parashikohet: *Kandidati ofertuesi duhet të dorëzojë: Leje mjedisore të tipit C (III.1.A) Për pastrim, larje, sprucim, ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose konteniervë në mënyrë që të ripërdoren. Kërkesa e mësipërme është diskriminuese dhe pengon OE të marrin pjesë në prokurime mbi bazën e një kërkesë të paplotë. Theksojmë se OE Medi Tel shpk operon duke përdorur kontenitorë plastikë njëpërdorimësh dhe si i tillë pajisjen me impjant për larjen apo dezinfektimin e kontenitorëve (Leje mjedisore të tipit C (III.1.A) e shikon totalisht të panevojshme sepse kontenitorët që kjo shoqëri përdor asgjesohen bashkë me mbetjet dhe nuk ka asgjë për tu larë*

apo dezinfektuar. Në këto kushte AK nuk ka të drejtë të vendosë një kërkesë kaq diskriminuuese por duhet ta heqë atë ose ta zëvendësojë me:

*Kandidati ofertuesi duhet të dorëzojë Leje mjedisore të tipit C (III.1.A) Për pastrim, larje, sprucim, ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierte në mënyrë që të ripërdoren ose një vetdeklarim, ku deklarohet se kontenioret që ai përdor janë njëpërdorimësh. Kriteri i mësipërm shkel nenin 2 të LPP.*

*Sa më sipër kërkojmë që ky kriter duhet të hiqet nga AK ose të plotësohet Leje Mjedisore e tipit C (III.1.A) Për pastrim, larje, sprucim, ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierte në mënyrë që të ripërdoren ose një vetdeklarim, ku deklarohet se kontenioret që ai përdor janë njëpërdorimësh”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se*

III.1.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.1./c “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

- *Leje mjedisore te tipit C (III.1.A) Per ” Pastrim ,larje , sprucim ose veshje e mbetjeve te ambalazheve /paketimeve ose kontenierteve ne menyre qe te riperdoren”.*

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikime teknike”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

*1.Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe anatomike duhet te asgjesohen ne nje impiant per incinerimin i cili eshte i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e ketij sherbimi sipas percaktimeve te meposhtme:*

*Ne mbeshtetje te Ligjit Nr 10463 date 22.09.2011 ” Per Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve”*

*Udhëzuesin Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore , Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr 798 date 29.09.2010 ” Per miratimin e rregullores ” Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore ”.*

- *Mbetje Me KODIN : KODI 18 01 01,18 01 03,18 01 04 sipas Katalogut shqiptar te mbetjeve ,ose ekuivalente sipas VKM 798 ,Date 29.09.2010 do te asgjesohen sipas VKM 798 , Date 29.09.2010 ” Per administrimin e mbetje spitalore ”Shtojca 3 ) ” Metodat per trajtim dhe asgjesim”, Pika 2 ) Me autokllavim ,shtojca 5 ) ” Standarte teknike per incenerim dhe autokllavim e Mbetjeve Spitalore ” .Kjo metode e mbeshtetur ne Udhëzim Kombëtar ” Per Menaxhimin e Mbetjeve Te rrezikshme Spitalore”dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhëzuesin Kombëtar ” Administrimi i Sigurt I mbetjeve Spitalore ” Seksioni 7.1 Tabela 1*
- *Mbetjet me KODIN : KODI 18 01 02 dhe 18 01 09 ose ekuivalente sipas VKM 798 ,Date 29.09.2010 do te asgjesohet sipas VKM 798 ,Date 29.09.2010 ” Per administrimin e mbetjeve spitalore ” Shtojca 3) ” Metodat per trajtim dhe asgjesim ” Pika 1) ” Incenerim ” , Shtojca 5 ) ”Standarte teknike per incenerimin dhe*

*autoklavimin e Mbetjeve Spitalore "Kjo metode e mbeshtetur ne Udhezimin Kombetar "Per menaxhimin e Mbetjeve Spitalore " dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhezuesin Kombetar " Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore , Seksioni 7.1 ,Tabela 1*

*2.Terheqja e mbetjeve do te behet sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor .Mbetjet duhet te meren nga kontraktuesi prane Autoritetit Kontraktor me mjet te posacem te sipermaresit dhe me ambalazhimin perkates ne perputhje me standartet per mbetjet e rrezikshme spitalore duke respektuar standartin sipas VKM 798 , date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore " dhe Udhezuesin Kombetar "Administrimi i Sigurt I Mbetjeve Spitalore "*

*3. Trajtimi /Asgjesimi duhet te realizohet ne zbatim te Vendimit Te Keshillit te Ministrave nr 798 date 29.09.2010 , per miratimin e rregullores " Per administrimin e mbetjeve spitalore " (Rregullorja ), si dhe Udhezuesit Kombetar te Administrimit te sigurte te mbetjeve spitalore".*

*4.Mbetjet do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve nga nje peshore ,e cila duhet te disponohet nga Operatori Ekonomik .*

*5.Qeskat dhe kontenieret plastike shumeperdorimesh duhet te mbulohen nga sipermaresi dhe duhet te sigurohet larja dhe desinfektimi i tyre ne cdo riperdorim. Kontenieret duhet te jene me kapacitet si vijon:*

- Kontenieret e vegjel per mbetjet e mprehta ,kontenier plastik , minimalisht 2 permasa me kapacitet qe fillojne nga 3 L –nga 1 moster per secilin permase;*
- Konteniret e medhenj per mbetjet me potencial infekues dhe ato te pergjithshmet , kontenitor plastik shoqeruar me qese te verdhe me 1 perdorim ,minimalisht 4 permasa me kapacitet qe fillojne nga 30 L (nga keto te pakten njera nga permasat duhet te jete me pedale dhe te pakten njera nga permasat te kete opsionin e levizshmerise me karrele )- nga 1 moster per secilen permase.*

*Sipas perpacktimeve te bera ne VKM 798 date 29.09.2010 , "Per administrimin e mbetjeve spitalore "si dhe Udhezuesit kombetar " Administrimii i Sigurte i mbetjeve spitalore " Te gjithë kontenieret qe perdoren nga Spitali duhet te merren nga firma dhe te behet dezinfeksimi i tyre prej saj.*

*6.Operatori Ekonomik duhet te pajisi A.K. me sinjalistike dhe tabela sinjalizuese te cilat tregojne prezencen e mbetjeve te rrezikshme ne ambientin perkates te autoritetit Kontraktor , ne baze te VKM Nr 798. Date 29.09.2010 dhe udhezuesit kombetar " Administrimi i Sigurte i mbetjeve Spitalore " .*

*7.Operatori ekonomik dhe Perfaqesuesit e Spitalit per cdo dorezim mbetjesh spitalore tek operoret per asgjesim do te mbajne " Dokumentin e dorezimit te mbetjeve te Rrezikshme "*

sipas VKM Nr 371 date 11.06.2014 “ Per miratimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te dokumentit te dorezimit e tyre “ Saktesia e plotesimit te dokumentave te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme “, do te sigurohet nepermjet dokumentit te peshimit dhe Operatori duhet te mbaje evidencat perkatese si dhe te dhenat e ciklit te perpunimit per cdo asgjesim.

8.Mbetjet e vecanta te vendosura ne ambalazh do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te dy paleve, hartohet proces –verbali per sasine e peshuar ne tre kopje dhe nenshkruhet nga sipermarsi dhe perfaqesuesi i autoritetit kontraktor .Dy kopje mbahen nga AK dhe nje kopje e merr kontraktuesi. Pesha e mbeturinave te rrezikshme spitalore do te llogaritet neto duke zbritur peshen e ambalazhit .

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.4. Në nenin 28 pika 5 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: ”5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose. [...]”

III.1.5. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenet 1 dhe 2, parashikohet shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.

Ky ligj përcakton: a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë; b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

III.1.6. Në neni 4 “Sistemi i lejeve të mjedisit” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, parashikohet shprehimisht: “1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë: a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij

ligji; b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji; c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/C të këtij ligji.”

III.1.7. Në shtojcën 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, përcaktohet: ”Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti kufi nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo”

III.1.8. Në ligjin Nr.52/2020 Për dis ndryshime në ligjin nr.10448 dtaë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar parashikohet si më poshtë:

- Në pikën 1 paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë: Në përputhje me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 Për mbrojtjen e mjedisit krijohet një sistem prej dy nivelesh të lejeve të mjedisit të tipave A e B si më poshtë:
- Në pikën 1 shkronja c shfuqizohet
- Në pikën 2 shkronja ç shfuqizohet
- Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C të cilat nuk klasifikohen si leje mjedisi të tipit B sipas pikës 1 të këtij neni me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përketë rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.1.10. Në rastin konkret, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me disponueshmërinë e Leje mjedisore te tipit C (III.1.A) Per ” Pastrim ,larje , sprucim ose veshje e mbetjeve te ambalazheve /paketimeve ose konteniereve ne menyre qe te riperdoren” nuk është më në përputhje me parashikimet e fundit ligjore. Sikundër cituar më sipër ligjvënësi ka vendosur të bëjë ndryshime në sistemin e lejeve mjedisore duke përcaktuar se në përputhje me ligjin nr.10431



datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” krijohet një sistem lejesh mjedisore me dy nivele konkretisht tipi A dhe B duke u shfiqizuar të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C të cilat nuk klasifikohen si leje mjedisi të tipit B. Në këto kushte, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e fundit ligjore duke evituar kështu vendosjen e kriterëve të cilat janë në tejkalim të normave në fuqi. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kriterit lidhur me Leje mjedisore te tipit C (III.1.A) Per ” Pastrim ,larje , sprucim ose veshje e mbetjeve te ambalazheve /paketimeve ose konteniereve në mënyrë që të ripërdoren” , pasi Lejet Mjedisore të tipit C sipas ndryshimeve të fundit ligjore janë shfuqizuar dhe nuk lëshohen më nga autoritetet kompetente.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pura Medical” shpk për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në datën 01.06.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, Nr.REF-59407-05-29-2020 me objekt “*Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore ,ne Drejtorine e Sherbimit Spitalor Pogradec –Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat (24 muaj)*“, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 8,450,000, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.06.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec.

III.2.2. Në datën 09.06.2020 operatori ekonomik “Pura Medical” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.2.3. Me shkresën nr.219 prot datë 10.06.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit ku ka vendosur refuzimin e ankesës për shkak të paraqitjes së ankesës jashtë afateve ligjore.

III.2.4. Në datën 15.06.2020 pala ankimuese “Pura Medical ” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor. Në formularin e ankesës së depozituar pranë KPP, operatori ekonomik ankimues pretendon që i është drejtuar autoritetit kontraktor nëpërmjet postës elektronike dhe shërbimit postar në datën 04.06.2020.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të

*Agjencisë së Prokurimit Publik.” Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.2.6. Në rastin konkret referuar formularit të ankesës, si dhe dokumentacionit shoqërues të saj rezulton se ankesa e operatorit ekonomik “Pura Medical” shpk është dorëzuar në protokollin e autoritetit kontraktor më datë 09.06.2020. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në dy momente të veçantë të lex specialis Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Në rastin e ankesave kundër vendimeve të autoritetit kontraktor ( referuar nenit 63 pika 2 të LPP-së) në të cilën parashikohet se “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktori paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji” afati procedural për paraqitjen e ankesës pranë këtij të fundit si shkallë e parë e ankimit nis nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni. Ndërkohë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, lex specialis ka parashikuar se llogaritja e afateve të ankimit nis nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe se operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paraqesin ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe jo nga dita e nesërme e punës. K.P.P. gjykon se vetë ligjvënësi ka ndarë dy momentet e mësipërme në lidhje me llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankimit administrative pranë autoritetit kontraktor, ku në rastin e ankimit për dokumentet e tenderit ka parashikuar se llogaritja e afateve nis nga dita e publikimit të njoftimit të kontratës në S.P.E. Referuar datës së publikimit të njoftimit të kontratës në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe datës së dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, K.P.P. konstaton se ankimi i operatorit ekonomik “Pura Medical” shpk është paraqitur jashtë afatit 7 ditor pranë autoritetit kontraktor dhe ky i fundit nuk legjitimohet racione temporis. Ankimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të

mosrrespektimit të afateve të ankimimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj dhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medi Tel” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, Nr.REF-59407-05-29-2020 me objekt “*Trajtimi dhe evadimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore, në Drejtorinë e Sherbimit Spitalor Pogradec –Marreveshje Kuader me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të percaktuara – me afat (24 muaj)*“, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 8,450,000, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.06.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pura Medical” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 544 Protokolli, Datë 11.06.2020**

**Nr.573 Protokolli, Datë 15.06.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

